



Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 11.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.08.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “EOR GROUP SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. të Prok: 616 21 3844 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Eor SHPK”, të dt. 05.08.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. 616 21 3844 121 Nr. Brendshëm **616-21-106-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 17.05.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kthej ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit;*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “ EOR shpk” me datë 05.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. 616 21 3844 121 Nr. Brendshëm **616-21-106-1-2-1**,

Institucionet vartëse te Drejtorisë së Kulturës ”, me Nr. 616 21 3844 121 Nr. Brendshëm **616-21-106-1-2-1**,

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

-Pretendimet lidhur me mungesën e specifikimeve teknike,katalogut dhe autorizimit në tenderin e tenderuesit te propozuar për dhënje të kontratës janë të bazuara,pasi që në ofertën e dorëzuar nga i njejt i ato dëshmi mungojnë.


Bazuar në këtë mangësi kam vendosur që aktiviteti të kthehet në rivleësim dhe çdo veprim në atë fazë të jetë ne harmoni me dispozitat ligjore duke përfshirë edhe kërkesat për sqarime dhe plotësime.

Zyrtari përgjegjës nga Departamenti i Prokurimit duhet të kërkoj formimin e komisionit të rivlerësimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit